

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË VITI, sipas gjyqtarit Raif Fazliu dhe sekretares juridike Mejreme Uka, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Nasip Sinani nga Mogilla, Komuna e Klllokotit, për shkak të kundërvajtjes sipas nenit 6 paragrafi 2. e sanksionuar me nenin 16, paragrafi 1. pika 2. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publikë, e në pajtim me nenin 73 dhe 195, të Ligjit mbi Kundërvajtjet me datë 20.09.2011. merrë këtë:

A K T V E N D I M

I pandehuri Nasip Adem Sinani, i lindur me 06.12.1962, në Mogillë, tani Komuna e Klllokotit, ku edhe jeton, zëvendës kryesues i Kuvendit të Komunës së Klllokotit, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 1 fëmije gjendja ekonomike i varfër, gjerë me tani kinse i pa dënuar, shqiptar i Rep. së Kosoves.

Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse duke qenë në pozitën e zyrtarit të lartë publik, Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klllokotit, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë, dhuratave dhe prejardhjen e tyre për vete dhe anëtarët e familjes, edhe pse këtë deklarim ka qenë i detyruar ta bëjë brenda afatit të caktuar ligjor, apo deri më 31. mars të vitit 2011.

Me çka ka bërë kundërvajtje e paraparë me nenin 6, paragrafi 2. e sanksionuar me nenin 16, paragrafi 1. pika 2. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publikë.

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr Prot
Dep. <u>D. P</u>	Br. Prot. <u>03-4184/11</u>
Dep.	Prot No
Nr. i faq.	Data
Broj stranica	Datum <u>28.10.2011</u>
Nr. pages <u>01(Ax2)</u>	Date

D Ë N O H E T

ME DENIM GJOBE, në shumë prej 150 €. të cilin dënim-gjobë është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasë plotfuqishmerisë së këtij aktvendimi, në të kundërtën i njejt do t'i zëvendësohet me dënim burgu në kohzgjatje prej 10 ditësh, duke i llogaritur nga 15 euro për çdo ditë të qëndrimit në burg, konform nenit 5 paragrafi 1. të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Obligohet i pandehuri ti paguaj kësaj Gjykate paushallin në shumë prej 5 €. konform nenti 109 paragrafi 1. pika 6 e Ligjit mbi kundërvajtjet.

A r s y e t i m

Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit z. Hasan Preteni, ka paraqitur kërkesë me nr. të protokolit 01-3203/11, e datës 15.07.2011, për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit, Nasip Sinani për shkak të kundërvajtjes të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e pranoi kërkesën dhe konstatoi se ajo është e bazuar në ligj.

Më qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata fitoi dhe mori në pyetje të pandehurin i cili deklaroi se nuk kishte patur për qëllim që të fsheh ndonjë pasuri të krijuar, apo çfardo dhurate të pranuar nga ai personalisht apo ndonjë familjar i tij, por kjo ka ardhur nga se nuk e kishte ditur se në mënyrë periodike duhet vazhduar me dërgimin e të dhënave pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit, spse do ta bënte pa kurrfar hezitimi apo vonese. Për këtë lëshim i pandehuri, fajësoi Kryetarin e Komunës, i cili si duket vetëm të pandehurin nuk e kishte paisur me formular për plotësim me të dhëna të sakta, lidhur me pasurinë që kishte, apo eventualisht të krijuar, për periudhën raportuese.

Në fund i pandehuri, pasi u deklarua se është person i varfër, emocionalisht u shpreh mbi obligimin të çdo qytetari që ta paraqes ë ta paraqes çfardo lloji të korrupsionit, duke e betuar në ate, por edhe duke garantuar dhe siguruar se në të ardhmen nga pozita e tillë e zyrtarit të lartë publik, kurrë nuk do të lejoj që t'i ndodhë përsëritja e kundërvajtjes së njejt.

Gjykata shqyrtoi kërkesen e organit kompetent dhe duke u bazuar në të dhënat e mjaftueshme që ka ajo, por edhe në deklaratën e të pandehurit konstatoi faktin se i pandehuri është pergjegjes për kundërvajtjen e cila i vebet në barrë, sepse nuk e ka dërguar me kohë dhe fare hiç, formularin mbi deklarimin e pasurisë së vetë, apo për antarët e familjes së tij.

Me rastin e shqiptimit të këtij dënimi gjykata është bazuar në pozitën e lartë juridike që në shoqëri ka i pandehuri, obligimin e pranuar ligjor për ta bërë këtë i pandehuri, çfardo që kërkohet nga ai, por gjithësesi edhe rrethanat lehtësuese se i pandehuri vërtetë nuk e kishte ditur se duhet vazhdimisht me e paraqitur pasurinë për periudhën që kërkohet nga ai, pastaj gjendjen shpirtërore të tij, duke kërkuar ndjesë gjatë dhënjes së deklaratës para gjyqtarit, të cilit me të vërtetë nuk ia kishin dorëzuar formularët për t'i plotësuar, por edhe gjendjen ekonomike jo të mirë në familje, gjithnjë pas sigurimit dhe garantimit nga ai se në të ardhmen nuk do ta përsërisë kurrë kundërvajtjen, e gjithë kjo duke besuar se vërtetë tek i pandehuri ky dënim do të ndikoj pozitivisht për të ardhmen.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle u mor nga gjykata, duke u bazuar në nenin 109 të LMK-së.


Nga të cekuarat më lartë u vendos si në dispozitiv.

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË VITI

Regj. 4075/2011

Më: 20.09.2011

Sekretarja juridike:
Mejreme Uka



Gjyqtari:
Fazliu

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij vendimi palët e kënatura mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 8 ditësh, Gjykatës së Lartë të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.